



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3881 / Prot
2

Laç, më 03.09. 2025

VENDIM

Nr. 27, datë 29 / 08 .2025

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES (TIP) PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS BASHKISË KURBIN DHE MINISTRIT PËRGJEGJËS PËR ÇËSHTJET VENDORE PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË SHQIPËRISË, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”.

Në mbështetje të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurës”, të ndryshuar, të ligjit nr.80/2021 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.252, datë 20.04.2023 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve”, si dhe relacionit me nr.3881 prot, datë 22.08.2025 “Për miratimin e marrëveshjes (tip) për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Bashkisë Kurbin dhe Ministrit Përgjegjës për Çështjet Vendore për zhvillimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore të shqipërisë, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, pas propozimit nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli Bashkiak Kurbin në mbledhjen e datës 29.08.2025;

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.


2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Kurbin në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur.
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Kurbin si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimin dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Kurbin të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet Ministrit Përgjegjës për Çështjet Vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.405 dt. 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë” dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s.
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Kurbin të përfaqësojë Bashkinë Kurbin në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Kurbin nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA-s.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

- Prefektit të Qarkut Lezhë
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- Drejtoria e Financës
- Arkivi

SEKRETARI I KËSHILLIT
Arber LEKA



KRYETARË E KËSHILLIT
Edlira LLESHI

